



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 28. 2. 2023

Nr. 1185 Prot.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT PËR PUBLIKIMIN DHE TRANSMETIMIN E SPOTEVE TË FUSHATËS EDUKUESE, INFORMUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE PËR ZGJEDHJET E 14 MAJIT 2023

Për : Operatorin ekonomik "Black Box" me NUIS L62412020P

Rruga Jeronim De Rada, nr 67, Tiranë

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** "Publikimi dhe transmetimi në mediat sociale dhe platformave online i spoteve edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuese në kuadër të zgjedhjeve të 14 majit 2023".

**Fondi limit i përcaktuar:** Fondi limit i procedurës është në vlerën 7.200.000 (shtatëmilionedyqindmijë) lekë me Tvsh, i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për vitin 2023.

**Kohëzgjatja e kontratës:** Nga nënshkrimi i kontratës deri në 14 maj 2023.

**Publikime të mëparshme:** Nuk zbatohet.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Çmimi më i ulët dhe kontratat e mëparshme

Njoftojmë se kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria "Dodo.al" me NUIS L91611012D, e cila për shërbimet e kërkuara paraqiti ofertën ekonomike me vlerë 7,360,000(Shtatëmilionëetreqindegjashtëdhjetëmijë) lekë pa T.V.SH.



2. Shoqëria **"Tillate.al"** me NUIS L51402019E, e cila për shërbimet e kërkuara paraqiti ofertën ekonomike me vlerë 7,300,000 (Shtatëmilionëetreqindmijë) lekë pa tvsh.
3. Shoqëria **"Black Box"**, me NUIS L62412020P, e cila paraqiti ofertën ekonomike me vlerë 7,200,000 (Shtatëmilionëedyqindmijë) lekë pa T.V.SH.

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Operatori ekonomik Shoqëria **"Dodo.al"** me NUIS L91611012D, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i plotëson të gjitha kriteret kualifikuese të përcaktuara në Ftesën për ofertë.
  - Nuk plotëson kërkesën e kriterëve kualifikuese, pasi nuk ka paraqitur vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore ku të vërtetohet se subjekti i ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjithë detyrimet e sigurimeve shoqërore;
  - Nuk plotëson kërkesën e kriterëve kualifikuese, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion (kontrata ose fatura tatimore) që të provojë se operatori ka realizuar gjatë tre viteve të fundit shërbime të së njëjtës natyrë.
  - Nuk plotëson kërkesën e kriterëve kualifikuese, pasi nuk ka paraqitur projekt ide të realizimit të paketës promovuese.
  - Nuk plotëson kërkesën e kriterëve kualifikuese, pasi nuk ka paraqitur CV dhe kualifikime profesionale të stafit kryesor të shoqërisë.

2. Operatori ekonomik Shoqëria **"Tillate.al"**, me NUIS L51402019E, pasi nuk plotëson kriteret kualifikuese të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk ka dorëzuar bilance financiare

- Nuk ka vërtetim për pagesat e sigurimeve Shoqërore
- Nuk ka depozituar vërtetim për pagesat e detyrimeve tatimore
- Nuk plotëson kërkesën e pikës 5, të kriterëve kualifikuese, pasi nuk ka paraqitur CV dhe kualifikime profesionale të stafit kryesor të shoqërisë.
- Nuk ka paraqitur dokumentacion (kontrata ose fatura tatimore) që të provojë se operatori ka realizuar gjatë tre viteve të fundit shërbime të së njëjtës natyrë.
- Nuk plotëson kërkesën e kriterëve kualifikuese, pasi nuk ka paraqitur projekt ide të realizimit të fushatës edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuere të fushatës së Zgjedhjeve Vendore të 14 Majit 2023.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“Black Box”** sh.p.k., me L62412020P dhe adresë: Rruga Jeronim De Rada, nr 67, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 7,200,000 (Shtatë milionë e dyqind mijë) lekë pa T.V.SH., është identifikuar si oferta e suksesshme për kontratën me objekt **“Publikimi dhe transmetimi në rrjetet sociale dhe platformat online të fushatës edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuere në kuadër të zgjedhjeve të 14 majit 2023.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me adresë: Rruga Ibrahim Rugova Nr 4, Tiranë me numër kontakti **++355 4 4510810**, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi për të vijuar me procedurën e lidhjes së kontratës.

Ankesa: Nuk ka patur.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I KQZ**

**YLLI MERKAJ**

